



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



23.05.2025
02/139

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/
Datë: 15.05.2025

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në bazë të nenit 11, 12 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 4 neni 5 par. 5.1 shkronja (b,d) neni 12, 14 par. 1 neni 17, neni 40, Ligjit, nr. 06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 17 par. 17.1 dhe 2, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale neni 10, 19, Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. 02/484, dt. 10.01.2024, miratim paraprak të listës së pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025, i konfirmuar sipas Konfirmimit të MAPL-së, nr. 020/27/11 dt. 22.01.2025 dhe Statutit të Komunës së Malishevës, nr. 02/441, dt. 14.09.2023,

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhje e mbajtur me datë, 15.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

*PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUJTSHME PUBLIKE PËRMES
PROCEDURËS SË ANKANDIT PUBLIK DERI NË 15 VITE*

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës miraton, kërkesën e kryetarit të komunës së nr. 01/575, dt. 13.05.2025, për iniciimin e procedurës administrative për formimin e komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme publike, në procedurë të ankandit publik.
2. Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi, formohet komisioni vlerësues me këtë përbërje:
 - 2.1 Astrit Sertolli
 - 2.2 Zamira Morina
 - 2.3 Muharrem Morina
 - 2.4 Kujtim Stollqi
 - 2.5 Dibran Kastrati
3. Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Vlerësues janë të përcaktuara si në Ligjin, nr. 06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë, kërkesa e kryetarit të komunës, nr. 01/523, dt. 02.05.2025.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i komunës.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe 7 (shtat) ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;

- 1.MAPL-së ,
- 2.Zyrës së Kryetarit,
- 3.Arkivit të komunës.

